



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1. pikën b) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Avokatura Istrefi” Sh.P.K. të datës 17.03.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontratës të datës 13.03.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës - Ritender” me nr. të prokurimit 616-21-3575-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 21 002 211/1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Avokatura Istrefi” Sh.P.K. e datës 17.03.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontratës të datës 13.03.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës - Ritender” me nr. të prokurimit 616-21-3575-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 21 002 211/1.
- II. VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontratës i datës 13.03.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHET** operatori ekonomik “Avokatura Istrefi” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Avokatura Istrefi” Sh.P.K. (tutje “parashtuesi”) me datë 17.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontratës të datës 13.03.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës - Ritender” me nr. të prokurimit 616-21-3575-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 21 002 211/1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë si në vijim:

1. **Pretendimi i parë:** “arsyeja e dhënë nga autoriteti kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit lidhur me faktin se të gjithë operatorët ekonomik janë të papërgjegjshëm, është arsye e pabazuar”.
2. **Pretendimi i dytë:** “arsyeja e dhënë nga autoriteti kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit lidhur me faktin se nuk ka buxhet të mjaftueshëm për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit, është arsye e pabazuar”.

Për shkak të pretendimit si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 8, 9, 22, 39, 40, 41, 54, 56, 59, 60, 62, 64, 66, 69 dhe dispozitat tjera të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 23.03.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar si prova raporti i komisionit për rivlerësim i datës 13.03.2023, njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontratës i datës 13.03.2023, njoftimi i i datës 20.01.2023 i njësishë kërkuese (Drejtoria e Administratës). Parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për të mbështetur pretendimet e tij.

Pas analizimit të pretendimit të parashtruesit është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimin. Rrjedhimisht pretendimi është i pabazuar pasi që nga provat e administruara mund të vërtetohet e kundërta e pretendimit sipas elaborimeve në vijim.

Lidhur me pretendimin e parë: fillimisht duhet cekur që sipas nenit 43.5 paragrafit b të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”) përcaktohet se “Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet nëse asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm”. Përmes raportit të komisionit për rivlerësim të datës 13.03.2023 është evidentuar se asnjë nga tenderuesit nuk është i përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit. Për këtë arsye është dashur të veprohet sipas nenit 43.5 paragrafit b të RRPP.

Duhet cekur që është i vërtetë fakti se një ndër kërkesat e autoritetit kontraktues sipas aneksit 6 të DT ka qenë se “operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit”. Komisioni i rivlerësimit përmes raportit të vet ka gjetur se nga parashtruesi me rastin e tenderimit janë dorëzuar tri (3) referenca njëra prej të cilave thuhet të jetë lëshuar nga “InterAdria” Sh.P.K e cila referohet në punën që pretendohet të jetë kryer duke filluar nga muaji janar i vitit 2017. Mirëpo me rastin e analizimit të dosjes së parashtruesit, komisioni përmes certifikatës së biznesit ka gjetur se parashtruesi “Avokatura Istrefi” Sh.P.K. është themeluar me datë 30.01.2018. Rrjedhimisht komisioni ka arritur deri te konstatimi se kjo referencë që është dorëzuar nga parashtruesi ka përmbajtje të pavërtetë për shkak se tenderuesi në referencë pretendon se ka ofruar shërbime juridike në janar të vitit 2017 ndërsa përmes certifikatës së biznesit vërtetohet se është themeluar më se një (1) vit më vonë (30.01.2018). Lidhur me këto të gjetura të komisionit të rivlerësimit, parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim është shprehur se mospërputhje e datave i referohet faktit se para se të themelohet “Avokatura Istrefi” Sh.P.K., përfaqësuesi aktual i saj Arbër Istrefi përmes një biznesi të tij individual (B.I.) ka punuar për kompaninë “InterAdria” Sh.P.K. që ka lëshuar referencën kontestuese. Njëkohësisht parashtruesi është shprehur se janë dorëzuar edhe dy (2) referenca tjera të cilat janë të mjaftueshme për të përmbushur kriterin e kërkuar sipas aneksit 6 të DT. Në këtë mënyrë zyrtari përgjegjës i prokurimit ka vlerësuar me kujdes argumentet e parashtruesit dhe të gjeturat e komisionit për rivlerësim. Me këtë rast është gjetur se argumenti i parashtruesit se referenca është dorëzuar në emër të një operatori tjetër ekonomik përkatësisht një biznesi individual (BI) që ka pasur përfaqësuesi i parashtruesit është argument plotësisht kontraverz dhe i pabazuar pasi që parashtruesi ka tenderuar në këtë aktivitet të prokurimit si operatori ekonomik “Avokatura Istrefi” Sh.P.K. dhe jo si grup i operatorëve ekonomik. Prandaj nuk mund të shfrytëzoj referencat e një operatori tjetër ekonomik për nevojat e tenderuesit aq më pak kur bëhet fjalë për punë që janë kryer më shumë se një vit para se të themelohet operatori ekonomik tenderues. Ky veprim si i tillë krijon hapësirë për t’u interpretuar edhe si tendencë për mashtrim të autoritetit kontraktues përmes dokumenteve me përmbajtje të pavërtetë në kuptim të destinimit të tyre. Duhet pasur parasysh që aktiviteti i prokurimit për të cilin bëhet fjalë ka të bëjë me përfaqësimin ligjor të autoritetit kontraktues. Prandaj natyra dhe rëndësia e këtij aktiviteti të prokurimit manifestojnë zero tolerancë për veprime të tilla të kundërligjshme nga tenderuesit. Nga ky këndvështrim, nuk përbën rrethanë balancuese as pjesa tjetër e argumentit sipas të cilit tenderuesi ka dorëzuar edhe dy referenca tjera që nuk janë kontestuar nga komisioni. Pra fokusi mbetet te referenca “InterAdria” Sh.P.K. që nga komisioni është gjetur se ka “përmbajtje të pavërtetë” rrjedhimisht edhe mashtruese kundër autoritetit kontraktues. Kujtojmë se përmes nenit 99 paragrafit 2 të LPP përcaktohet se “në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare”. Pra nuk bëhet fjalë për dilemë nëse parashtruesi është dashur të shpallet i papërgjegjshëm ose jo pasi që janë plotësuar kushtet për vendosjen e tij edhe në listën e zezë nga OSHP.

Me këtë rast ndërmjet argumenteve kontraverze që ka paraqitur parashtuesi si më sipër dhe raportit të komisionit për rivlerësim si provë materiale që është administruar në këtë rast, zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotës provës materiale. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë i parashtuesit është tërësisht i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë: fillimisht duhet cekur se përmes nenit 62 paragrafit 1 nënparagrafit 2 të LPP përcaktohet se "Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës nëse të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit". Njëkohësisht përmes nenit 43.7. të RRPP është përcaktuar se Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsye të mëposhtme: a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK". Tutje duhet sqaruar se buxheti i planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit në vitin 2021 ka qenë 600,000 Euro ndërsa kontrata publike kornizë është parashikuar të lidhet në kohëzgjatje prej tri (3) viteve buxhetore (2021-2023). Për shkak të shumës së konsiderueshme, kjo nënkupton që në secilin vit buxhetor janë planifikuar të ndahen shumat propocionale për këtë aktivitet të prokurimit. Mirëpo ky aktivitet i prokurimit i cili është shpallur në vitin 2021, si i tillë është stërzgatur për shkak të ankesave të ndryshme dhe nuk është përfunduar deri në vitin 2023 sipas njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Parashtuesi në kërkesën e tij për rishqyrtim lidhur me pretendimin e dytë ka potencuar se "deri më sot këto mjete ende nuk janë shpenzuar por janë bartur në vazhdimësi në vitet pasuese". Mirëpo vet parashtuesi e kundërshton argumentin e tij vetëm disa fjali më poshtë kur konstaton se "Sipas buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2023, për këtë aktivitet të prokurimit janë ndarë 150,000 Euro". Në këtë mënyrë parashtuesi sërish paraqitet kontraverz në tentimin e tij për të argumentuar pretendimet e kërkesës për rishqyrtim. Sidoqoftë, parashtuesi ka prezantuar edhe një argument tjetër lidhur me pretendimin e dytë të cilin e ka formuluar si në vijim: "*Megenëse me LPP dhe me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik (janar 2021) pika 56.11, fq. 126, lejohet tejkalimi i kontratave publike kornizë deri në 30% të vlerës indikative, në rastin konkret shuma e ndarë prej 150,000.00 Euro mund të tejkalohet edhe për 45,000.00 Euro dhe të arrihet shuma prej 195,000.00 Euro, ndërsa nga shërbimet tona të ofruara në të kaluarën, asnjëherë nuk e kemi shpenzuar në tërësi*". Duhet theksuar se me datë 20.01.2023 Drejtoria e Administratës në Komunën e Prishtinës në cilësi të njësisë kërkuuese për këtë aktivitet të prokurimit ka dërguar njoftimin zyrtar në sektorin e prokurimit sipas të cilit nga vitet paraprake 2021 dhe 2022 nuk janë bartur mjetet e planifikuara për këtë aktivitet të prokurimit ndërsa aktualisht në vitin 2023 për këtë aktivitet janë të planifikuara vetëm 150,000 Euro (dhe jo 600,000 siç kanë qenë të planifikuara në vitin 2020). Njëkohësisht për vitin 2024 dhe 2025 nuk janë paraparë mjete për shërbimet përkatëse lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Në këtë mënyrë është gjetur se është i paqëndrueshëm argumenti i parashtuesit se ekziston buxheti i planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit nga autoriteti kontraktues. Duhet cekur është mjaft shqetësues deklarimi i hapur i parashtuesit që në rast se do të rekomandohej për kontratë, synimi i tij konsiston në tejkalimin e buxhetit për 30% duke prezantuar edhe shifrat se si do të duken në këtë rast.

Natyrish se autoriteti kontraktues në asnjë rast nuk lejon tejkalimin e kundërligjshëm të buxhetit të planifikuar për një aktivitet të prokurimit. Kjo për arsye se një veprim i tillë jo vetëm që është i kundërligjshëm por krijon edhe hapësira të mëdha për keqpërdorime. Natyrish se sasisë indikative që përcaktohen me rastin e shpalljes së tenderit, janë vetëm llogaritje të përfërta dhe jo të sakta domosdoshmërisht. Prandaj në kuptim të nenit 54.10 dhe 54.11 të RRPP, mospërputhje e lejuar me sasisë indikative mund të jetë deri +/- 30%. Pra nëse pas lidhjes së kontratës lindin rrethana të reja sipas të cilave duhet të kërkohen shërbime/punë/artikuj shtesë nga kontraktuesi, atëherë kjo mund të bëhet por jo duke tejkaluar +30% të sasive indikative dhe anasjelltas (mund të kërkohen më pak nga kontraktuesi por jo më pak se -30% të sasive indikative). Mirëpo kjo është rrethanë e ardhshme e paparashikueshme për të cilën duhet të plotësohen kushtet përkatëse ligjore. Në asnjë mënyrë nuk mundet tenderuesi të paragjykoj se për një kontratë të caktuar duhet të tejkalohej vlera e buxhetit për 30% sikurse ka deklaruar parashtruesi lidhur me pretendimin e dytë në kërkesën për rishqyrtim.

Me këtë rast ndërmjet argumenteve sërish kontraverze që ka paraqitur parashtruesi si më sipër dhe konfirmimit për buxhetin në dispozicion të autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit sipas njoftimit të njësisë kërkuese të datës 20.01.2023 si provë materiale të administruar në këtë rast, zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotës provës materiale. Në këtë mënyrë është gjetur se edhe pretendimi i dytë i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Duhet shtuar se në fund të kërkesës së tij për rishqyrtim, parashtruesi ka paraqitur ka potencuar edhe disa argumente shtesë duke tentuar që të mbështetë të dy (2) pretendimet e tij si më sipër. Me këtë rast parashtruesi ka potencuar se autoriteti kontraktues ka lidhur një kontratë me negocim pa publikim të njoftimit për kontratë me një operator ekonomik tjetër i cili nuk është në garë për këtë aktivitet të prokurimit. Sa i përket këtij argumenti, duhet cekur se parashtruesi ka bërë referencë në një aktivitet krejt tjetër të prokurimit me numër tjetër të prokurimit dhe me numër tjetër të brendshëm. Ndërsa kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit i referohet një aktiviteti tjetër të prokurimit me numrat identifikues të prezantuar në hyrje të këtij vendimi. Pra nuk është as i logjikshëm dhe aq më pak i bazuar ky argument i parashtruesit. Si i tillë nuk është fare relevant dhe as mbështetës për asnjërin pretendim të parashtruesit. Në këtë mënyrë edhe pas analizimit të argumenteve shtesë përmbyllëse të parashtruesit është gjetur se të dy (2) pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara.

Për arsyet e elaboruara si më sipër është vendosur që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e datës 17.03.2023 e parashtruesit "Avokatura Istrefi" Sh.P.K. kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontratës të datës 13.03.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës - Ritender" me nr. të prokurimit 616-21-3575-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 21 002 211/1.

Për pikën I të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.1. lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën II është vendosur duke u bazuar në nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin 2 të LPP lidhur me nenin 43.5. paragrafit b dhe nenit 43.7 të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 23.03.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.